



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORE  
DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE INVESTIMEVE TË HUAJA

Nr. 10832 Prot 2

Vlorë, më: 28 . 09 2022

DEGJESË PUBLIKE

Mbi Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 si dhe planifikimi për Projekt Buxhetin e vitit 2023 për Bashkinë Vlorë

NJËSIA ADMINISTRATIVE- NOVOSELË

Data 14.09.2022: ora 10.00

Marrin pjesë: Kryetari i Bashkisë Vlorë, nënkryetarja e Bashkisë Vlorë, Kryetari i NJ.A Novoselë, kryetarë fshatrash, Drejtorë të Administratës dhe Institucioneve të Bashkisë Vlorë, shoqeri civile, media lokale dhe banorë të njësisë. (*listeprezenca bashkangjitur*)

**Kanan Shakaj**.-Kr. NJ.A. Ky takim organizohet për PBA 2023 dhe planifikimin e buxhetit për vitin 2023. Kemi bërë takime neper fshatra dhe kemi mbledhur problematikat dhe prioritetet e secilit fshat. Falenderojmë administratën e bashkisë për korrektësinë dhe bashkepunimin si dhe nënkryetaren e bashkisë znj. Aulona Veizi për prezencën sot në takim. E kuptojmë vështirësinë e planifikimit të buxhetit faktik për investimet që duhen. Nga planifikimi ka mbetur pa realizuar rruga Skofotine-Poro, nga sheshi te varrezat.

Disa nga problematikat sipas fshatrave:

**Akerni:** rrugët e brendshme, ujesjellesi, Kanalet e ujrave te zeza, kullimi i brendshem i tokës.

**Novosele:** shëtitorja e Novoselës, kanalizimet e ujrave të bardha dhe të zeza, vaditja

**Fitore:** shtrimi i rrugëve te brendshme. Pastrimi i kanaleve kulluese dhe vaditja,

**Bishan:** menaxhimi i tokave,

**Poro;** rrugët e brendshme

**Trevllazër:** Rruga e Çeçajve deri te varrezat, ujesjellësi, hapja e rrugëve në parcela.

**Cerkovine:** Rruga e Varrezave, pastrimi

**Mifoline:** rrjeti i ujesjellesit

**Mifol:** Rruga e Ceçajve, rrethimi i varrezave

**Aliban:** rruget e brendshme, kullimi dhe vaditja.

**Daut Zeraj:** buxheti i vitit 2023 do të marrin prioritet nevojat me emergjente. Ne buxhetin afatmesem është parashikuar një rritje rreth 6% për vitin 2024 dhe 2025 dhe për vitin 2023 nuk do të ndryshoj për arsye se është edhe vit zgjedhor. Realizimi për vitin 2022 nuk është 100% për arsye të rritjes së çmimeve rreth 20-30% dhe pritet që realizimi të jetë diku 80-90 % për vitin 2022. Ato investime që janë parashikuar do mundohemi ti realizojme. Shtesa për rritjen e parashikuar do të jetë kryesisht në investime në sektorin e arsimit si shkolla, kopshte e cerdhe. Buxheti parashikohet të shkojë 46 milion leke. Gjithashtu edhe pastrimi do të ketë rëndësi. Për vitin 2024 do të ketë rritje të buxhetit me 20% dhe për vitin 2025 rritja do të jetë 30%.

Të tjerat do të perpiqemi ti mbyllim në buxhetin e 2023. Me të ardhurat e bashkisë.

**Kanan Shakaj:** Me urgjencë kemi rruget e brendshme dhe rrethinat e varrezave për 3 fshatra; Cerkovine, Trevllazer dhe Mifol.

**Qytetari** , Kr. Cerkovine: varrezat, kanalizimet, depua e ujit.

**Qytetari** , Kr. Mifol: rruget e parcelave që janë zaptuar, kanalet kulluese që janë bllokuar nga mbetjet, Lagja e Cobajve duhet shtruar rruga.

**Kanan Shakaj:** probleme me pronësinë. Certifikatat zgjidhin problemet.

**Qytetari** . Jemi të përjashtuar nga çdo projekt, as ujë të pijshëm, tokat me parcelat e bllokuara, probleme dhe konflikte pronësie, 250 rrenje ullinje të djegur dhe smorra asnjë kompensim nga shteti, stacionet e pompave janë të prishura, ndricim në rrugë nuk ka.

**Aulona Veizi:** Ke aplikuar për subvencion për grurin?

**Kanan Shakaj:** në Aliban projekti ka ngelur. Sahatet ku do të çohen kur s'ka linjë?

**Qytetari** : problem me rruget e brendshme, pastrimi i kanaleve kulluese, kazanet e mbeturinave mungojnë.

**Kanan Shakaj:** do ta zgjidhim pastrimin.

**Dritan Leli:** administrata do të përgatisë dokumentacionin për në keshill. Ka pas probleme dhe është adresuar problemi i pronësisë. Rr. Varrezave do të jetë prioritet dhe do të adresohet në buxhetin e 2023. Problemi i ujesjellesit do të shikohet dhe do të bëhet me e mira për të dhënë një zgjidhje . Do të kemi bashkëpunimin e qeverisë shqiptare në projekte të reja por edhe për ujesjellsin. Dokumentat e shpronësimeve dhe zgjidhja e problemit të ujit janë prioritete. E rëndësishme është të jemi të gjithë për të adresuar problematikat për buxhetin 2023 dhe programimin afatmesëm 2023-2025. Do të diskutohet perseri dhe do të reflektohen në buxhetin e vitit 2023.

Qytetar –Cerkovine. Projekti i Ujesjellesit në zonën tonë nuk ka të perfshire 10 fshatra!

**Dritan Leli:** të diskutojme që aty ku mungon uji ta adresojme si problematike me lart. Kemi mungese informacioni të percjelle nga njesia. Inspektimet ne terren duhet te behen sipas nevojave, verifikimeve dhe situates si dhe mungesave. Sillni mungesat! Ti drejtohem i muncuesit, Alibani ka sahat por s'ka linja uji! Të vihet linja dhe ta permiresojme problemin.

Qytetar -Kr.plaku i fshatit Fitore- kemi dhe pune te mira te realizuara ne njesine tone.

Qytetar : linja te lidhet, jo me rezervuar, por me pompe te fuqishme qe e shperndan ujin ne linje. Ka neglizhence ne menaxhim.

**Dritan Leli:** Keto jane takime fillestare qe mbledhim informacionin nga secili fshat dhe do te vazhdojne deri ne fund te tetorit para se ta cojme ne keshill qe te kemi mundesi ta permiresojme duke ju referuar ehd kontratave te vjetra dhe nisjes se procedurave.

**Sonela Haxhiraj-Dr. Juridike-** Do shikojme tarifate si dhe rishikojme shifrat qe godinat te marrin jete.

**Dritan Leli:** Do te rishikohen ne gjithe territorin e bashkise edhe per godinat e trashegimise kulturore. Ngrehinat mund te shnderrohen ne stalla dhe mund te perfitojne fonde dhe investime per te permiresuar infrasturkturen dhe ekonomine e territorit. Kush ka interest e ofrohet.

Si eshte situata me arsimin? Ka largime?

**Kanan Shakaj:** ne vitin 2011 ka patur 750 nxenes dhe ne 2022 vetem 90 nxenes te regjistruar. Ka familje qe largohen cdo dite.

**-Shoq. Civile:** Te permiresohet informacioni. S'ka shifra te sakta. Zona ka pasuri dhe ska informacion per vizitoret se ku mund ti vizitoj. Nuk dihen oraret e transportit publik.

**Dritan Leli:** Si tw permiresohet?

**Mejtin Mece-** jemi te pranishem per çdo problem në njësi.

**Dritan Leli:** ketu shikon komunitete qe sillen me qytetari me mjedisin. Duan zhvillimin. Akernia nje vend i prapambetur do të marr zhvillim me investimin strategjik që do të behet. Komuniteti ka qene pro pavaresisht për ndjeshmerine e mjedisit per projektin e aeroportit.

Ju falenderoj te gjithe. Pavaresisht problemeve do punohet për adresimin!

**Hartoi**

**Albana Naçi**

Koordinatorë për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Bashkia Vlorë

